**REPUBLIKA E SHQIPERISE**

MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT

**MINISTRI**

# URDHER

Nr. 76, Date 21. 06. 2007

**PER**

## ZBATIMIN E RREGULLOREVE PER PARREZIKSHMERINE NE FLUTURIM NE AVIACIONIN CIVIL

Ne mbeshtetje te pikes 4, te Nenit 102 dhe Nenit 122 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, Marreveshjes se ECAA nenshkruar ne 9 Qershor 2006, ku parashikohet detyrimi i Republikes se Shqiperise per t'u bere anetar i JAA (Autoriteteve te Bashkuara te Aviacionit Civil), deri ne miratimin e Kodit Ajror te Republikes se Shqiperise,

**URDHEROJ:**

1. Zbatimin e JAR-eve (Kerkesave te Perbashketa te Aviacionit), legjislacionit europian ne fushen e parrezikshmerise ne fluturim, si dhe amendamenteve te tyre nga subjektet operuese te kesaj fushe ne vendin tone, ne perputhje me kushtet aktuale te Aviacionit Civil Shqiptar, deri ne miratimin e Kodit Ajror te RSH.
2. Ngarkohet Drejtoria e Politikave te Transportit Ajror ne MPPTT te pergatise gjate kesaj kohe projekt rregulloret e kesaj fushe, ne gjuhen shqipe, qe do te dalin ne baze dhe per zbatim te Kodit Ajror te RSH.
3. Per zbatimin e pikes 1 te ketij Urdheri, ngarkohet Drejtoria e Pergjithshme e Aviacionit Civil.
4. Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

**SOKOL OLLDASHI**

**MINISTER**